



Nga Plaku Rasëll M. Nelson,
i Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve

Mbështetja e Profetëve

Mbështetja e profetëve nga ana jonë është një zotim vetjak se ne vërtet do të bëjmë më të mirën për t'i përkrahur përparësitë e tyre profetike.

Presidenti Ajring, ju falënderojmë për mesazhin tuaj udhëzues dhe frymëzues. Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, ju falënderojmë për besimin dhe përkushtimin tuaj. Dje, secili prej nesh u ftua ta mbështeste Tomas S. Monsonin si profetin e Zotit dhe Presidentin e Kishës së Zotit. Dhe shpesh ne këndojmë: “Të falemi, Zot, për profetin”¹. A e kuptojmë ju dhe unë me të vërtetë se çfarë do të thotë kjo? Përfytyrojeni privilegjin që Zoti na ka dhënë për ta mbështetur profetin e Tij, këshilla e të cilit do të jetë e panjollësuar, e palustruar, e pashtyrë nga ndonjë synim vetjak dhe tërësisht e vërtetë!

Si e mbështetim me të vërtetë një profet? Kohë përpara se të bëhej President i Kishës, Presidenti Jozef F. Smith shpjegoi: “Është një detyrë e rëndësishme, e vendosur mbi shenjtorët të cilët . . . i mbështetin autoritetet e Kishës, që ta bëjnë këtë jo vetëm duke ngritur dorën, që është pamja e dukshme, por me anë të *veprimt* dhe me të vërtetë”².

Më kujtohet mirë “veprimi” im më i pashoq për ta mbështetur një profet. Si mjek dhe si kirurg kardiolog, pata përgjegjësinë e kryerjes së një operacioni në zemër të hapur te Presidenti Spenser W. Kimball në vitin 1972, kur

ai ishte Presidenti Veprues i Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve. Ai kishte nevojë për një operacion shumë të ndërlikuar. Por unë nuk kisha përvojë në kryerjen e një procedure të tillë te një pacient 77-vjeçar me pamjaftueshmëri kardiake. Nuk e rekomandova operacionin dhe këtë ia njoftova Presidentit Kimball dhe Presidencës së Parë. Por, me besim, Presidenti Kimball zgjodhi ta bënte operacionin, vetëm ngaqë iu këshillua prej Presidencës së Parë. Kjo tregon se si ai i mbështeti udhëheqësit e tij! Dhe vendimi i tij më bëri të dridhem!

Falë Zotit, operacioni doli me sukses. Kur zemra e Presidentit Kimball filloi të rrihte përsëri, ajo rrahu me fuqi të madhe! Pikërisht në atë çast, pata një dëshim të qartë prej Shpirtit se ky burrë do të bëhej një ditë Presidenti i Kishës!³

Ju e dini çfarë ndodhi. Vetëm 20 muaj më vonë, Presidenti Kimball u bë Presidenti i Kishës. Ai siguroi udhëheqje të guximshme dhe plot kurajë për shumë vite.

Që nga ajo kohë ne i kemi mbështetur Presidentët Ezra Taft Benson, Hauard W. Hanter, Gordon B. Hinkli dhe tani Tomas S. Monson si President të Kishës – profetë me çdo kuptim të fjalës!

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, nëse Rivendosja bëri diçka, ajo e copëtoi mitin e lashtë se Perëndia ka pushuar së foluri fëmijëve të Tij. Asgjë nuk mund të jetë më larg nga e vërteta. Një profet ka qëndruar në krye të Kishës së Perëndisë në të gjitha periudhat e kujdestarisë ungjillore, që nga Adami deri në ditën e sotme.⁴ Profetët dëshmojnë për Jezu Krishtin – qenien e Tij hyjnore dhe misionin e shërbesës së Tij tokësore.⁵ Ne e nderojmë Profetin Jozef Smith si profeti i kësaj periudhe të fundit të kujdestarisë ungjillore. Dhe e nderojmë secilin burrë që e ka pasuar atë si Presidentin e Kishës.

Kur i mbështetim profetët dhe udhëheqësit e tjerë⁶, ne përdorim ligjin e miratimit të përbashkët, sepse Zoti tha: “Përsëri unë ju them se nuk do t’i jepet askujt që të shkojë për të predikuar ungjillin tim, ose për të ngritur kishën time, përveçse nëse ai shugurohet nga dikush që ka autoritet e njihet prej kishës që ka autoritet dhe është shuguruar në mënyrë të rregullt nga krerët e kishës”⁷.



Kjo na jep neve, si anëtarë të Kishës së Zotit, bindje dhe besim teksa përpigemi ta zbatojmë urdhrin e dhënë në shkrimet e shenjta për t'ia vënë veshin zërit të Zotit⁸, kur ai vjen nëpërmjet zërit të shërbëtorëve të Tij, profetëve.⁹ Të gjithë udhëheqësit në Kishën e Zotit thirren nëpërmjet autoritetit të duhur. Asnjë profet apo ndonjë udhëheqës tjetër në këtë Kishë, për atë arsye, nuk e ka thirrur kurrë veten e tij ose të saj. Asnjë profet kurrë nuk është thirrur nëpërmjet zgjedhjeve. Zoti e bëri atë të qartë kur Ai tha: “Nuk më keni zgjedhur ju mua, por unë ju kam zgjedhur juve; dhe ju caktova”¹⁰. Ju dhe unë nuk “votojmë” për udhëheqësit e Kishës, të çfarëdo niveli. Ne, megjithatë, vërtet kemi privilegjin për t'i mbështetur ata.

Udhët e Zotit janë të ndryshme nga udhët e njeriut. Udhët e njeriut i heqin njerëzit nga detyrat ose bizneset kur ata plaken apo bëhen të paaftë fizikisht. Por udhët e njeriut nuk janë dhe kurrë nuk do të jenë udhët e Zotit. Mbështetja e profetëve nga ana jonë është një zotim vetjak se ne vërtet do të bëjmë më të mirën për t'i përkrahur përparësitë e tyre profetike. Mbështetja jonë është një tregues i betuar se ne e pranojmë thirrjen e tyre si profet që të jetë ligjëruese dhe detyruese për ne.

Njëzet e gjashtë vjet përpara se të bëhej President i Kishës, në atë kohë Plaku Xhorxh Albert Smith tha: “Detyrimi që ne marrim përsipër kur ngremë dorën . . . është një nga më të shenjtët. Ai *nuk* do të thotë se ne do të shkojmë qetësisht në udhën tonë dhe do të jemi dakord që profeti i Zotit ta drejtojë këtë punë, por do të thotë . . . se ne do ta mbështetim atë; ne do të lutemi për të; ne do të mbrojmë emrin e tij të mirë dhe ne do të përpigemi t'i plotësojmë udhëzimet e tij ndërsa Zoti do ta drejtojë.”¹¹

Zoti i gjallë e udhëheq Kishën e Tij të gjallë!¹² Zoti ia zbulon profetët



të Tij vullnetin e Tij për Kishën. Dje, pasi u ftuam ta mbështetnim Tomas S. Monsonin si President të Kishës, ne gjithashtu patëm privilegjin ta mbështetnim atë, këshilltarët në Presidencën e Parë dhe anëtarët e Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve si profetë, shikues e zbulues. Merreni me mend! Ne mbështetim 15 burra si profetë të Perëndisë! Ata mbajnë të gjithë çelësat e priftërisë që i janë dhënë ndonjëherë njeriut në këtë periudhë të kujdestarisë ungjillore.

Thirrja e 15 burrave në detyrën e shenjtë të apostullit na jep mbrojtje të madhe si anëtarë të Kishës. Përse? Sepse vendimet e këtyre udhëheqësve duhet të jenë të njëzëshme.¹³ A mund ta përfytyroni se si Shpirti ka nevojë që t'i nxitë 15 burra për të sjellë njëzshmërinë? Këta 15 burra kanë përvojë të shumëllojshme arsimore dhe profesionale, me opinione të ndryshme rreth shumë gjërave. Besomëni! Këta 15 burra – profetë, shikues e zbulues – e dinë se cili është vullneti i Zotit kur arrihet njëzshmëria! Ata zotohen për t'u kujdesur që vullneti i Zotit të bëhet me të vërtetë. Lutja e Zotit siguron modelin për secilin prej këtyre 15 burrave, kur ata luten: “U bëftë vullneti yt në tokë si në qiell”¹⁴.

Apostulli me vjetërsinë më të madhe në detyrën e Apostullit, kryeson.¹⁵ Ai sistem i vjetërsisë do të sjellë zakonisht burra më të moshuar në detyrën e Presidentit të Kishës.¹⁶ Ai siguron vazhdimësi, pjekuri të sprovuar, përvojë dhe përgatitje të gjithanshme, siç u drejtua nga Zoti.

Kisha sot është organizuar nga Zoti Vetë. Ai ka vendosur një sistem të mrekullueshëm të udhëheqjes, i cili siguron njerëz zëvendësues për kryerjen e funksioneve. Ai sistem e siguron udhëheqjen profetike edhe kur sëmundjet apo paaftësitë e pashmangshme mund të vijnë në moshën e thyer.¹⁷ Kundërpeshimet dhe përkujdesjet shtohen që askush të mos mundet ta drejtojë ndonjëherë Kishën në udhë të gabuar. Udhëheqës me përvojë po mësohen në mënyrë të vazhdueshme që një ditë të jenë gati për t'u ulur në këshillat më të larta. Ata mësojnë se si ta dëgjojnë zërin e Zotit nëpërmjet pëshpëritjeve të Shpirtit.

Ndërsa shërbente si Këshilltar i Parë i Presidentit Ezra Taft Benson, i cili po i afrohej në atë kohë fundit të jetës së tij në vdekshmëri, Presidenti Gordon B. Hinkli shpjegoi:

“Parimet dhe procedurat, të cilat Zoti i ka vendosur për qeverisjen



e Kishës së Tij, marrin masa për çdo . . . rrethanë. Është e rëndësishme . . . që të mos ketë asnjë dyshim apo shqetësim lidhur me qeverisjen e Kishës dhe ushtrimin e dhuntive profetike, duke përfshirë të drejtën për frymëzim e zbulesë në administrimin e punëve dhe programeve të Kishës, kur Presidenti mund të sëmuret apo nuk është në gjendje të veprojë plotësisht.

Presidenca e Parë dhe Këshilli i Dymbëdhjetë Apostujve, të thirrur e të shuguruar që të mbajnë çelësat e priftërisë, kanë autoritetin dhe përgjegjësinë për ta qeverisur Kishën, për t'i administruar ordinancat e saj, për ta sqaruar doktrinën e saj dhe për t'i themeluar e mirëmbajtur procedurat e saj."

Presidenti Hinkli vazhdoi:

"Kur Presidenti është i sëmurë apo i paaftë për të vepruar plotësisht në të gjitha detyrat e pozitës së tij, dy Këshilltarët e tij së bashku përbëjnë një Kuorum të Presidencës së Parë. Ata e vazhdojnë punën e përditshme të Presidencës. . . .

Por çfarëdo pyetje e rëndësishme rreth politikës, procedurave, programeve apo doktrinës merret në shqyrtim me hollësi dhe lutje nga Presidenca e Parë dhe Të Dymbëdhjetët së bashku."¹⁸

Vitin që shkoi, kur Presidenti Monson arriti 5-vjetorin e shërbimit si President i Kishës, ai u shpreh rreth 50 viteve të tij të shërbimit apostullor dhe bëri këtë deklaram: "Mosha më së fundi e vendos peshën e saj të rëndë mbi të gjithë ne. Megjithatë, ne e bashkojmë zërin tonë me Mbretin Benjamin, i cili tha: . . . 'Unë jam sikurse ju, mund të prekem nga të gjitha llojet e dobësive në trup dhe mendje; megjithëkëtë, unë jam zgjedhur . . . dhe përkushtuar nga ati im . . . dhe jam mbajtur dhe ruajtur nga fuqia e tij e pakrahasueshme, për t'ju shërbyer juve me të gjithë fuqinë, mendjen dhe forcën që Zoti më ka dhënë' (Mosia 2:11)."

Presidenti Monson vazhdoi: "Pavarësisht nga ndonjë sfidë shëndetësore që mund të na vijë, pavarësisht nga

ndonjë dobësi në trup apo mendje, ne shërbejmë sa më mirë që kemi aftësi. Unë ju siguroj se Kisha është në duar të sigurta. Sistemi i ngritur për Këshillin e Presidencës së Parë dhe të Kuorumit të Dymbëdhjetë [Apostujve na] siguron që ajo do të jetë gjithmonë në duar të sigurta dhe se, çfarëdo që të ndodhë, nuk ka nevojë për t'u shqetësuar apo për të pasur frikë. Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti, të cilin e ndjekim, të cilin e adhurojmë dhe të cilit i shërbejmë, është gjithmonë në timon."¹⁹

Presidenti Monson, ne ju falënderojmë për ato të vërteta! Dhe ju falënderojmë për jetën shembullore dhe shërbimin tuaj të përkushtuar. Mendoj se flas për anëtarët e Kishës në mbarë botën në shprehjen tonë të bashkuar e të sinqertë të mirënjohjes për ju. Ne ju nderojmë! Ne ju duam! Ne ju mbështetim, jo vetëm me duar të ngritura, por me gjithë zemrat dhe përpjekjet tona të përkushtuara. Me përlulësi dhe nderim, "ne përher' lutemi për ty"²⁰, i dashuri, profeti ynë! Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. "Të Falemi, Zot, për Profetin", (*Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 36).
2. *Teachings of Presidents of the Church: Joseph F. Smith* (1998), f. 211; theksimi i shtuar. Ky pohim u bë në vitin 1890, kur Presidenti Smith ishte Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë.
3. Për më shumë hollësi, shih Spencer J. Condie, *Russell M. Nelson: Father, Surgeon, Apostle* (2003), f. 153–156.
4. Shih Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, "Periudhë", f. 146.
5. Një numër profetësh parashikuan ardhjen e Zotit, duke përfshirë Lehin (shih 1 Nefi 1:19), Nefin (shih 1 Nefi 11:31–33; 19:7–8), Jakobin (shih Jakobi [LiM] 4:4–6), Beniaminin (shih Mosia 3:5–11, 15), Abinadin (shih Mosia 15:1–9), Almën (shih Alma 40:2) dhe Samuel Lamanitin (shih Helamani 14:12). Përpara se Shpëtimtari të lindë në Bethlehëm, ata e parashikuan flijimin e Tij shlyes dhe Ringjalljen e Tij pasuese.
6. Parimi i mbështetjes së udhëheqësve është thelbësor anëmbanë Kishës së Zotit. Një

njeri mbështetet përpara se të veçohet në një thirrje apo të shugurohet në një detyrë në priftëri.

7. Doktrina e Besëlidhje 42:11. Praktika e mbështetjes së udhëheqësve tanë u vu në zbatim më 6 prill 1830, kur Kisha u organizua, dhe në mars të vitit 1836, kur anëtarë të Presidencës së Parë dhe të Kuoromit të Dymbëdhjetë Apostujve u mbështetën si profetë, shikues e zbulues (shih *History of the Church*, 1:74–77; 2:417).
8. Libri i Mormonit na paralajmëron për rrezikun nëse i shpërfillim mësimet profetike. Prej tij ne mund të lexojmë se “ndërtesa e gjerë dhe e madhe ishte kryelartësia e botës; dhe ajo ra dhe rënia e saj ishte jashtëzakonisht e madhe. Dhe engjëlli i Zotit . . . foli . . . duke thënë: I tillë do të jetë shkatërrimi i të gjitha kombeve, fiseve, gjuhëve dhe njerëzve që do të luftojnë kundër dymbëdhjetë apostujve të Qengjit” (1 Nefi 11:36).
9. Shih Daniel 9:10; Amosi 3:7; Doktrina e Besëlidhje 21:1, 4–5; 124:45–46.
10. Gjoni 3:16. Neni i pestë i besimit sqaron: “Ne besojmë se një njeri duhet të thirret nga Perëndia, me anë të profecisë dhe me anë të vënies së duarve prej atyre që janë në autoritet, për të predikuar Ungjillin dhe për të administruar ordinancat e tij”.
11. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Xhorxh Albert Smith* (2011), f. 63; theksimi i shtuar. Ky citim u mor prej një fjalimi konference nga Plaku Xhorxh Albert Smith në vitin 1919. Ai u bë President i Kishës në vitin 1945.
12. Shih Doktrina e Besëlidhje 1:30, 38.
13. Shih Doktrina e Besëlidhje 107:27.
14. 3 Nefi 13:10; shih edhe Mateu 6:10; Lluca 11:2.
15. Kur një president i Kishës vdes, Presidencia e Parë shkrihet dhe këshilltarët zënë vendet e tyre në Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve. Kuorumi i Të Dymbëdhjetëve më pas e kryeson Kishën derisa të riorganizohet Presidencia e Parë. Ajo periudhë kohe njihet si një interval midis dy drejtimeve apostullore. Historikisht, ai interval ka zgjatur në kohë nga katër ditë deri në tre vjet e gjysmë.
16. Sigurisht, ai model i pasimit nuk gjeti zbatim te thirrja e Jozef Smithit, i cili u parachugurua të ishte profeti i Rivendosjes dhe Presidenti i parë i Kishës (shih 2 Nefi 3:6–22; shih edhe Abraham 3:22–23).
17. Ne e dimë se Zoti Vetë mund ta thërrasë secilin prej nesh në shtëpi në çfarëdo kohe që Ai zgjedh.
18. Gordon B. Hinckley, “God Is at the Helm”, *Ensign*, maj 1994, f. 54; shih edhe Gordon B. Hinckley, “He Slumbers Not, nor Sleeps”, *Ensign*, maj 1983, f. 6.
19. “Message from President Thomas S. Monson”, *Church News*, 3 shkurt 2013, f. 9.
20. “We Ever Pray for Thee”, *Hymns*, nr. 23.



Nga Karol F. Mek-Konki,

Këshilltare e Parë në Presidencën e Përgjithshme të Të Rejave

Jetoni sipas Fjalëve të Profetëve

Për të qenë në harmoni me qëllimet hyjnore të qiellit, ne e mbështetim profetin dhe zgjedhim të jetojmë sipas fjalëve të tij.

Ati ynë në Qiell i do të gjithë fëmijët e Tij dhe dëshiron që ata ta dinë dhe kuptojnë planin e Tij të lumturisë. Prandaj, Ai thërret profetë, ata që janë shuguruar me fuqi dhe autoritet për të vepruar në emrin e Perëndisë për shpëtimin e fëmijëve të Tij. Ata janë lajmëtarë të drejtësisë, dëshmitarë të Jezu Krishtit dhe të fuqisë së pafundme të Shlyerjes së Tij. Ata i mbajnë çelësat e mbretërisë së Perëndisë në tokë dhe autorizojnë kryerjen e ordinancave shpëtuese.

Në Kishën e vërtetë të Zotit, “kurrë nuk ka përveçse një njeri mbi tokë gjatë një kohe, mbi të cilin kjo fuqi dhe çelësat e kësaj priftërie jepen”¹. Ne e mbështetim Presidentin Tomas S. Monson si profetin, shikuesin dhe zbuluesin tonë. Ai e zbulon fjalën e Zotit për ta udhëhequr dhe drejtuar të gjithë Kishën tonë. Ashtu si Presidenti J. Ruben Klark i Riu shpjegoi: “Vetëm Presidenti i Kishës . . . ka të drejtën që të marrë zbuluesin për Kishën”².

Lidhur me profetin e gjallë, Zoti i urdhëron njerëzit e Kishës së Tij:

“Ju duhet t’u vini veshin [të gjitha] fjalëve dhe urdhërimeve të tij, që ai do t’ju japë ashtu siç i merr ato, duke ecur gjithë shenjtëri përpara meje;

Sepse fjalën e tij duhet ta merrni si nga goja ime, plot durim e besim.

Pasi duke i bërë këto gjëra, portat e ferrit nuk do të hapen kundër jush.”³

Për të qenë në harmoni me qëllimet hyjnore të qiellit, ne e mbështetim profetin dhe zgjedhim të jetojmë sipas fjalëve të tij.

Ne gjithashtu i mbështetim këshilltarët e Presidentit Monson dhe Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve si profetë, shikues dhe zbulues. “Ata kanë të drejtën, fuqinë dhe autoritetin për të shpallur mendjen dhe vullnetin e [Zotit] . . . , në varësi të . . . Presidentit të Kishës.”⁴ Ata flasin në emrin e Krishtit. Ata profetizojnë në emrin e Krishtit. Ata i bëjnë të gjitha gjërat në emrin e Jezu Krishtit. Në fjalët e tyre ne dëgjojmë zërin e Zotit dhe ndiejmë dashurinë e Shpëtimtarit. “Dhe çfarëdo që ata do të flasin kur nxiten nga Fryma e Shenjtë, do të jetë shkrim i shenjtë . . . dhe fuqia e Perëndisë për shpëtim.”⁵ Zoti Vetë ka folur: “Qoftë nëpërmjet zërit tim apo nëpërmjet zërit të shërbëtorëve të mi, është njësoj”⁶.

Ne jemi mirënjohës për një kishë të “ndërtuar mbi themelin e apostujve dhe të profetëve, duke qenë Jezu Krishti vetë guri i qoshes”⁷. Shtëpia